


PJESA A: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 3 pikë

1. Mali lundroi me barkë rreth pesë ishujve, si në figurë. Rreth cilave ishuj lundroi Mali në kah të akrepave të orës?

- (A) 2, 3 dhe 4
- (B) 1, 2 dhe 3
- (C) 1, 3 dhe 5
- (D) 2, 4 dhe 5
- (E) 2, 3 dhe 5




2. Besniku i rivendos 5 pjesët e treguara në alternativa që ta fitojë numrin më të vogël të mundshëm 9-shifrorë. Cilën pjesë e vendos ai në fund (në anën e djathtë)?

- (A) 4
- (B) 8
- (C) 31
- (D) 59
- (E) 107

3. Kangurit Kengu i pëlqen të kërcëjë në vijën numerike.

Ai çdo herë i bën dy kërcime të gjata ndjekur nga tre kërcime të shkurtura, si në figurë, dhe pastaj e përsërit këtë proces pa u ndalur. Kengu e fillon rutinën e tij të kërcimit në numrin 0. Në cilin nga numrat e mëposhtëm do të prekë Kengu përgjatë rutinës së tij?

- (A) 82
- (B) 83
- (C) 84
- (D) 85
- (E) 86




4. Targa e makinës së Kreshnikut kishte rënë nga makina. Ai e rivendosi në vend përmbysur, por fatmirësisht kjo nuk bëri asnjë dallim. Cila nga targat vijuese mund të jetë targa e makinës së Kreshnikut?

- (A) 04 NSN 40
- (B) 60 HOH 09
- (C) 80 BNB 08
- (D) 03 HNH 30
- (E) 08 XBX 80

5. Ndërtuesi ka një tullë, brinja më e shkurtër e së cilës është 4 cm. Ai përdor disa tulla të tilla për të ndërtuar kubin që tregohet. Cilat janë dimensionet, në cm, të tullës së tij?

- (A)  $4 \times 6 \times 12$
- (B)  $4 \times 6 \times 16$
- (C)  $4 \times 8 \times 12$
- (D)  $4 \times 8 \times 16$
- (E)  $4 \times 12 \times 16$



6. Shushunja me ngjyrë hiri e të bardhë e treguar në figurë rrudhet që të fle. Cila nga mundësitë e mëposhtme mund të jetë pozita e rrudhur e shushunjës?

- (A)
- (B)
- (C)
- (D)
- (E)



7. Në barazimin e mëposhtëm ka pesë hapësira të zbrazëta. Sara dëshiron t'i mbush katër nga to me shenjën e plusit dhe një me shenjën e minusit në mënyrë që barazimi të jetë i saktë.


$$6 \square 9 \square 12 \square 15 \square 18 \square 21 = 45$$

Ku duhet ta vendos ajo shenjën e minusit?

- (A) Mes 6 dhe 9                      (B) Mes 9 dhe 12                      (C) Mes 12 dhe 15  
(D) Mes 15 dhe 18                      (E) Mes 18 dhe 21

8. Në një park, janë pesë pemë të mëdha dhe tri rrugë. Në cilën hapësirë të parkut duhet të mbillet një pemë e re në mënyrë që çdo rrugë të ketë numër të njëjtë pemësh në të dy anët e saj?

- (A) A                                      (B) B  
(C) C                                      (D) D  
(E) E



9. Sa numra natyrorë mes 100 dhe 300 kanë vetëm shifra tek?

- (A) 25                      (B) 50                      (C) 75                      (D) 100                      (E) 150

10. Genti shkroi shumën e katrorëve të dy numrave, si në figurë. Fatkeqësisht disa nga shifrat nuk mund të shihen sepse janë mbuluar me bojë. Cila është shifra e fundit e numrit të parë?

$$(23 \text{ [bluar]})^2 + (1 \text{ [bluar] } 2)^2 = 7133029$$

- (A) 3                      (B) 4                      (C) 5                      (D) 6                      (E) 7


PJESA B: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 4 pikë

11. Distanca mes dy rafteve në dollapin e kuzhinës së Marigonës është 36 cm. Ajo e di se një grumbull prej 8 gotave të preferuara të saj të vendosura njëra mbi tjetrën është i lartë 42 cm, kurse një grumbull prej 2 gotash është 18 cm i lartë. Sa është numri më i madh i gotave që mund të vendosen njëra mbi tjetrën në raft?



- (A) 3                      (B) 4                      (C) 5                      (D) 6                      (E) 7

12. Në zarin e zakonshëm, shuma e numrave të pikave në faqe të kundërta është gjithmonë 7. Katër zarë të zakonshëm janë ngjitur së bashku, si në figurë. Sa është numri më i vogël i pikave që mund të shfaqen në sipërfaqen e katër zareve të ngjitura?




- (A) 52                      (B) 54                      (C) 56                      (D) 58                      (E) 60

13. Tri motra, mosha mesatare e të cilave është 10, kanë secila mosha të ndryshme. Kur ato bëhen bashkë në çifte, moshat mesatare të dy çifteve të tilla janë 11 dhe 12. Sa është mosha e motrës më të vjetër?

- (A) 10                      (B) 11                      (C) 12                      (D) 14                      (E) 16

14. Trim Kopshtari mbolli tulipanë dhe lule margarita në një shtrat lulesh në kopsht në formë katrori me brinjë me gjatësi 12 m, të vendosura si në figurë. Sa është syprina e sipërfaqes së përgjithshme e pjesëve ku ai mbolli lulet margarita?



- (A)  $48\text{ m}^2$   
 (B)  $46\text{ m}^2$   
 (C)  $44\text{ m}^2$   
 (D)  $40\text{ m}^2$   
 (E)  $36\text{ m}^2$


15. Në zyrën time janë dy orë muri. Njëra orë muri shkon një minutë para çdo orë, kurse tjetra kthehet dy minuta prapa çdo orë. Dje i vendosa të dyja në kohën e saktë por kur i shikova sot vërejtja se njëra tregonte orën 11:00 kurse tjetra 12:00. Sa ishte ora kur i vendosa të dyja orët e murit në kohën e saktë?

- (A) 23:00                      (B) 19:40                      (C) 15:40                      (D) 14:00                      (E) 11:20

16. Vigani shkroi disa numra pozitivë më të vegjël se 7 në një copë letre. Rita pastaj i fshiu të gjithë numrat e Viganit dhe i zëvendësoi me ndryshimin e tyre nga numri 7. Shuma e numrave të Viganit ishte 22. Shuma e numrave të Ritës është 34. Sa numra kishte shkruar Vigani?

- (A) 7                      (B) 8                      (C) 9                      (D) 10                      (E) 11


17. Numrat nga 1 deri në 8 vendosen, secili një herë, në rrathët e treguar. Numrat afër shigjetave tregojnë prodhimet e tre numrave në rrathët në vijën e drejtë përkatëse. Sa është shuma e numrave në rrathët më të poshtëm në figurë?



- (A) 11                      (B) 12                      (C) 15                      (D) 17                      (E) 19


18. Syprina e prerjes së një rrethi me një trekëndësh është 45% e syprinës së unionit të tyre. Syprina e trekëndëshit jashtë rrethit është 40% e syprinës së unionit. Sa është përqindja e syprinës së rrethit që ndodhet jashtë trekëndëshit?

- (A) 20% (B) 25%  
 (C) 30% (D) 35%  
 (E) 50%



19. Në sa mënyra mund të mbulohet plotësisht forma në të majtë duke përdorur 9 pllaka si ato në të djathtë?

- (A) 1 (B) 6 (C) 8  
 (D) 9 (E) 12



20. Meritoni gjithmonë nget biçikletën me të njejtën shpejtësi si dhe gjithmonë ecën me të njejtën shpejtësi. Ai mund të shkojë nga shtëpia në shkollë dhe të kthehet në shtëpi për 20 minuta me biçikletë dhe për 60 minuta kur ecën. Dje Meritoni filloi të shkojë në shkollë me biçikletë por u ndal gjatë rrugës dhe e la biçikletën e tij te shtëpia e Evës, për të përfunduar udhëtimin e tij për në shkollë në këmbë. Gjatë rrugës prapa nga shkolla në shtëpi, ai eci deri te shtëpia e Evës, mori biçikletën e tij dhe shkoi në shtëpi me biçikletë. Ky udhëtim zgjati 52 minuta. Çfarë pjese të udhëtimit të tij e realizoi Meritoni me biçikletë?

- (A)  $\frac{1}{6}$  (B)  $\frac{1}{5}$  (C)  $\frac{1}{4}$  (D)  $\frac{1}{3}$  (E)  $\frac{1}{2}$

PJESA C: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 5 pikë

21. Jerina vendosi numra në hapësirat/qelizat e një table me dimensione  $3 \times 3$  në mënyrë që shuma e numrave në të gjithë katrorët e mundshëm me dimensione  $2 \times 2$  të jetë e njejtë. Numrat në tre prej qosheve janë vendosur tashmë, si në figurë. Cilin numër mund ta shkruajë ajo në hapësirën/qelizën me pikëpyetje?

- (A) 0 (B) 1 (C) 4 (D) 5 (E) 6


2		4
?		3

22. Fshatrat  $A, B, C$  dhe  $D$  janë të vendosura, jo domosdoshmërisht në këtë renditje, në një rrugë të gjatë e të drejtë. Fshatrat  $A$  dhe  $C$  janë 75 km larg, fshatrat  $B$  dhe  $D$  janë 45 km larg dhe fshatrat  $B$  dhe  $C$  janë 20 km larg. Cila nga përgjigjet vijuese nuk mund të jetë largësia mes fshatrave  $A$  dhe  $D$ ?


- (A) 10 km (B) 50 km (C) 80 km (D) 100 km (E) 140 km

23. Drejtkëndëshi i madh  $ABCD$  është ndarë në shtatë drejtkëndësja identikë. Sa është raporti  $\frac{AB}{BC}$ ?

- (A)  $\frac{1}{2}$  (B)  $\frac{4}{3}$  (C)  $\frac{8}{5}$  (D)  $\frac{12}{7}$  (E)  $\frac{7}{3}$




24. Një piktor dëshiroi t'i përziente 2 litra bojë ngjyrë të kaltër me 3 litra bojë ngjyrë të verdhë për të fituar 5 litra bojë ngjyrë të gjelbër. Megjithatë, ai gabimisht përdori 3 litra bojë ngjyrë të kaltër dhe 2 litra bojë ngjyrë të verdhë dhe fitoi nuancën e gabuar të ngjyrës së gjelbër. Sa është sasia më e vogël e bojës ngjyrë të gjelbër që duhet ta hedh në mënyrë që duke përdorur pjesën e mbetur të bojës ngjyrë të gjelbër dhe ca bojë shtesë ngjyrë të kaltër dhe/ose të verdhë, të fitojë 5 litra bojë me nuancën e saktë të ngjyrës së gjelbër?




- (A)  $\frac{5}{3}$  litra      (B)  $\frac{3}{2}$  litra      (C)  $\frac{2}{3}$  litra      (D)  $\frac{3}{5}$  litra      (E)  $\frac{5}{9}$  litra

25. Një ndërtuese ka dy tulla identike. Ajo i vendos ato afër njëra-tjetrës në tri mënyra të ndryshme, si në figurë. Syprinat e tri trupave të fituar janë 72, 96 dhe 102. Sa është syprina e tullës fillestare?



- (A) 36      (B) 48      (C) 52      (D) 54      (E) 60

26. Sa është numri më i vogël i hapësirave/qelizave që duhet të ngjyrosen në katrorin me dimensione  $5 \times 5$  në mënyrë që çdo drejtkëndësh me dimensione  $1 \times 4$  ose  $4 \times 1$  brenda katrorit të ketë të paktën një hapësirë/qelizë të ngjyrosur?



- (A) 5      (B) 6      (C) 7      (D) 8      (E) 9


27. Merita e pyet një zebër dhe një panterë cila ditë është sot. Zebra gjithmonë gënjen në ditët e hënë, e martë dhe e merkurë. Pantera gjithmonë gënjen në ditët e enjte, e premte dhe e shtunë. Zebra thotë "Dita e djeshme ishte ditë kur unë gënjej". Pantera thotë "Edhe për mua dita e djeshme ishte ditë kur unë gënjej". Cila ditë është sot?

- (A) E enjte      (B) E premte      (C) E shtunë      (D) E diel      (E) E hënë

28. Disa pika janë shënuar në një vijë. Rigoni pastaj e shënoi edhe një pikë mes çdo dy pikave të njëpasnjëshme në vijë. Ai e përsëriti këtë proces edhe tri herë të tjera. Tani janë 225 pika në vijë. Sa pika ishin shënuar në vijë në fillim?

- (A) 10      (B) 12      (C) 15      (D) 16      (E) 25

29. Një trekëndësh barakrahësh  $ABC$  me  $AB = AC$ , është ndarë në tre trekëndësha barakrahësh më të vegjël, si në figurë, në mënyrë që  $AD = DB$ ,  $CE = CD$  dhe  $BE = EC$ . Vini re se figura nuk është vizatuar në përmasa të sakta.



Sa është masa e këndit  $BAC$  në shkallë?

- (A) 24      (B) 28      (C) 30      (D) 35      (E) 36

**30.** Në shtatë parqe jetojnë 2022 kangurë dhe disa koala. Në secilin park jetojnë aq kangurë sa është numri i koalave në të gjitha parqet tjera. Sa koala jetojnë gjithsej në shtatë parqet?

(A) 288

(B) 337

(C) 576

(D) 674

(E) 2022